



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL  
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT/VENDIM

NR. DATË 28.02.2022

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE REALIZIMIT TË  
BUXHETIT TË BASHKISË DROPULL PËR VITIN 2021”.**

Në mbështetje të nenit 44 të Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”, nenit 65 të Ligjit Nr 9936, datë

26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 48 të Ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit Nr 88/2019, “Për Buxhetin e Vitit 2020”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr 22, datë 30.07.2018 ”Për Procedurat Standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të veteqeverisjes vendore », Vendimit të Këshillit të Bashkise Nr. 69 datë 22.12.2020 “Për miratimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe buxhetit të Bashkise Dropull per vitin 2021”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr 70, datë, 22.12.2020 “Për Miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesem, buxhetit vjetor, dhe monitorimit te tij per vitin 2021”, me propozim te Kryetarit te Bashkise

**KESHILLI BASHKIAK  
VENDOSI**

1. Miratimin e Raportit vjetor te monitorimit te zbatimit te buxhetit per vitin 2021 (Bashkangjitur).
2. Miratimin e te ardhurave dhe shpenzimeve faktike nga burimet e veta, të vitit 2021, si dhe të ardhurave të trashëguara për vitin 2022, si më poshte:

**Të ardhurat faktike për vitin 2021**

• Të ardhura të trashëguara nga viti 2021.....	<b>46.421.697</b>
• Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	<b>126.331.576</b>
• Të ardhurat të krijuara në vitin 2021 .....	<b>68.755.693</b>

**Shuma**

**241.508.966 lek**



























































































